



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1174 Prot
A

Tiranë, më 14 /10/2020

VENDIM

Nr. 46, datë 14.10.2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1174 Prot., datë 29.09.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Universiteti “Ismail Qemali, Vlorë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet shkresës datë 18.09.2020, ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vihet në dispozicion dokumentacioni/informacioni si më poshtë:

1. Në cilin vit akademik znj. _____ është punësuar në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë?
2. 1998-2003 kush ka ushtruar funksionin e Përgjegjësës së Departamentit të Lëndëve Mjekësore (vendimi nr, data)?
3. 2003-2008 kush ka ushtruar funksionin e Përgjegjësës së Seksionit të Lëndëve Mjekësore (vendimi nr, data)?
4. 2011 –2012 kush ka ushtruar funksionin e Përgjegjësës së Departamentit të Infermierisë (vendimi nr, data)?
5. 2012 –2016 kush ka ushtruar funksionin e Përgjegjësës së Departamentit të Infermierisë (vendimi nr, data)?
6. 2016 –2020 kush ka ushtruar funksionin e Përgjegjësës së Departamentit të Infermierisë (vendimi nr, data)?
7. 2020-2024 Përgjegjëse e Departamentit të Infermierisë (vendimi nr, data).

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1438/1 Prot., datë 22.09.2020 ka refuzuar vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar duke sqaruar se objekti i kërkesës përmban të dhëna personale.

Pas përgjigjes së dhënë nga autoriteti publik, ankuesja pretendon se nuk i është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar dhe si rrjedhojë ka depozituar pranë Komisionerit, ankesën nr. 1174 Prot., datë 29.09.2020, me objekt *"refuzimin e dhënies së informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare"*, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa është në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit" dhe ankuesja legjitimohet në kërkimin e saj.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: *"Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur"*, Komisioneri, me emailin e datës 08.10.2020 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit.

Autoriteti Publik, me emailin datë 12.10.2020 ka kthyer përgjigje duke sqaruar se, *"Referuar nenit 17, e drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton të drejtën për një jetë private. Vlerësojmë se ankuesja nuk provon interes të ligjshëm për të kërkuar informacionet objekt kërkesë. Konflikti midis znj. dhe znj. ka lindur për shkak të procesit zgjedhor të zhvilluar në UV për autoritet drejtues në datën 30.07.2020, ku dy pedagogët konkurruan për postin e Drejtuesit të Departamentit të Infermierisë në Fakultetin e Shëndetit Publik të UV-së. Në përfundim të procesit zgjedhor fituese doli pedagogia . UV-ja nuk mund të përfshihet në këtë mosmarreveshje postzgjedhore, pasi ato janë në kompetencë të komisionit zgjedhor institucional dhe më tej të gjykatave. Aktualisht Këshilli i Etikës në UV po zhvillon një hetim administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor që po zhvillohet me kërkesë të znj. kundër znj. "*

Bazuar në sa më sipër, nga konsultimi i legjislacionit përkatës dhe verifikimi i dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i Autoritetit Publik në shkresën nr.1438/1 Prot., datë 22.09.2020, si dhe në emailin e datës 12.10.2020, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Ligji i sipërcituar ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Për sa më sipër, mosveprimi në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe detyrimin sipas këtij vendimi, passjell vendosjen e penalteteve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 18, ndaj personave përgjegjës.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksonimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e znj. _____ ndaj Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1174 Prot., datë 29.09.2020 të znj. _____, kundër Autoritetit Publik Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, për vënien në dispozicion të dokumentacionit/informacionit të kërkuar në lidhje me: (1. Në cilin vit akademik znj. _____ është punësuar në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë? 2. 1998-2003 kush ka ushtruar funksionin e Përgjegjës së Departamentit të Lëndëve Mjekësore (vendimi nr, data)? 3. 2003-2008 kush ka ushtruar funksionin e Përgjegjës së Seksionit të Lëndëve Mjekësore (vendimi nr, data)? 4. 2011 –2012 kush ka ushtruar funksionin e Përgjegjës së Departamentit të Infermierisë (vendimi nr, data)? 5. 2012 –2016 kush ka ushtruar funksionin e Përgjegjës së Departamentit të Infermierisë (vendimi nr, data)? 6. 2016 –2020 kush ka ushtruar funksionin e Përgjegjës së Departamentit të Infermierisë (vendimi nr, data)? 7. 2020-2024 Përgjegjëse e Departamentit të Infermierisë (vendimi nr, data), brenda datës 21.10.2020.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 14.10.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

